




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MEMALIAJ

DREJTORIA JURIDIKE & BURIMEVE NJERËZORE



**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL,  
LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË E  
MESME DHE TE ULËT DREJTUES**

**Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike” niveli minimal i diplomës “Master Shkencor” ose  
“Profesional”**

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, **Bashkia Memaliaj** shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranim në shërbimin civil për pozicionin:

- 1(një) Përgjegjës Sektori ,Drejtorja e Tatimeve dhe Tarifave Vendore.
  - Kategoria e pagës III-3

*Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil*

**Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil )**

**aplikohet në të njëjtën kohë!**

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

**Lëvizje paralele: 12.03.2026**

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

**Parnim në shërbimin civil :19.03.2026**

## **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:**

- Është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punës në sektorin përkatës.
- Është përgjegjës për përgatitjen e parashikimeve mbi të ardhurat vjetore nga taksat dhe tarifave vendore, të cilin e çon për miratim tek titullari.
- Raporton mbi baza mujore pranë drejtorit për realizimin e të ardhurave për çdo taksë ose tarife vendore dhe është përgjegjës për realizimin e tyre.
- Kontrollon mënyrën e llogaritjes së detyrimeve përkatëse për çdo subjekt tregëtar.
- Është përgjegjës për kryerjen e akt-rakordimeve me strukturat përkatëse të Bashkisë dhe agjenteve tatimor, të cilat, i paraqet me pas për miratim pranë drejtorit.
- Bashkëpunon me përgjegjësit e sektoreve të tjerë të drejtorive duke shkëmbyer informacionndërmjet tyre.
- Kujdeset për mënyrën e mbajtjes së kontabilitetit, ndjek mënyrën e kontabilizimit dhe pagesën e detyrimeve tatimore.
- Raporton tek drejtori mbi numrin e subjekteve debitor dhe përgatit listën e debitoreve të cilën ja përcjell me pas sektorit të borxhit dhe sektorit të kontrollit çdo muaj.
- Përpunon informacionin e ardhur nga sektori i kontrollit në lidhje me subjektet e evidentuara dhe rregjistruara në terren si dhe organizon punën për llogaritjen dhe kontabilizimin e detyrimeve tatimore mbi bazën e këtij informacioni.
- Organizon punën dhe merr masa për njoftimin e subjekteve debitor.
- Jep informacione javore pranë drejtorit lidhur me pagesat e detyrimeve nga subjektet dhe numrin e debitoreve.
- Ndjek hartimin e projekt-buxhetit në tërësinë e elementeve të tij.
- Paraqet për miratim tek drejtori programet e punës.
- Mund të propozojë pranë drejtorit masa disiplinore për punonjësit në varësi që nuk zbatojnë detyrat, shkelin etikën apo disiplinën në punë.
- Zbaton detyrat e tjera të ngarkuara nga drejtori.
- Bën vlerësimin e punonjësve
- Harton analizën e punës sipas kërkesave që vijnë nga eprorët.
- Kontabilizon në mënyrë korrekte dhe periodike të gjitha detyrimet tatimore që përcillen në këtë zyrë nga inspektorët e taksave dhe tarifave.
- Bën rakordimin me sektorin e financës në bazë të postës për çdo bankë, apo pagesave të kryera në arkë.

- Bën rakordimin me agjentët tatimor dhe tregjet publike si dhe me faturistët për taksat dhe tarifat familjare.
- Harton ditarët e pagesave për çdo subjekt dhe rakordon me inspektoren e financës dhe buxhetit në bashki.
- Përpunon grafikisht dhe analitikisht të gjithë treguesit dhe të gjitha format statistikore të cilat kërkohen nga drejtori dhe përgjegjësi i sektorit.
- Prodhon informacione ditore, javore, mujore dhe vjetore.
- Në fund të çdo muaji paraqet pranë përgjegjësit të sektorit dhe drejtorit listën totale të debitoreve si dhe të ardhurat e realizuar gjatë muajit.
- Bashkepunon me të gjithë sektorët për sigurimin e të dhënave statistikore.
- Kontakton me të gjitha strukturat e drejtorisë për të marrë dhe shkëmbyer informacione
- Respekton etikën dhe disiplinën në punë.

## **1 LËVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### **1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria III-3);
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" ose "Master Profesional"
- Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- Të zotërojnë gjuhën angleze.

### **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:  
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

*Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion e Bashkisë Memaliaj, brenda datës 12.03.2026*

### **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **13.03.2026** njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të **Bashkisë Memaliaj** ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Agjensia Kombëtar e Punësimit dhe Aftësive” si dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Memaliaj [www.memaliaj.gov.al](http://www.memaliaj.gov.al) listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

### **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike".
- c) Njohuritë mbi Ligjin 9936, dt.26.06.2008 " Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- e) Njohuritë mbi Mbi Ligjin 9632, dt.30.10.2006 " Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar
- f) Njohuritë mbi Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"
- g) Njohuritë mbi Ligji Nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

## 1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedures së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur", të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al).

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## 1.6

## DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Komisioneri për Mbikëqytjen e Shërbimit Civil do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtar e Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit

## **2 PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

*Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21, të Ligjit Nr.152/2013, “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar*

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil

### **2.1**

#### **KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

- a- Të jetë shtetas shqiptarë
- b- Të ketë zotësi për të vepruar
- c- Të zotëroj gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur
- d- Të jetë në kushtet që e lejojnë detyrën përkatëse
- e- Të mos jetë i dënuar më vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje
- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon : Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor”osë “Profesional” në shkenca ekonomike (Diplomat të cilat janë marrë jshtë vendit,duhet të jeë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi)

- d) Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- e) Të zotërojnë gjuhën angleze.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:  
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

*Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 19.03.2026, Bashkia Memaliaj.*

Në datën 23.03.2026, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të **Bashkisë Memaliaj**, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” si dhe në faqen [www.memaliaj.gov.al](http://www.memaliaj.gov.al) listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike".
- c) Njohuritë mbi Ligjin 9936, dt.26.06.2008 "Per Menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise"
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- e) Njohuritë mbi Mbi Ligjin 9632, dt.30.10.2006 " Per sistemin e taksave vendore", I ndryshuar
- f) Njohuritë mbi Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"
- g) Njohuritë mbi Ligji Nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## **2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur", të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al).

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## **2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, **Bashkia Memaliaj** do të shpallë fituesin në portalin "Agjencia Kombëtar e Punësimit dhe Aftësive". Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.